



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:191616

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05444848

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit SH.S., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër debitores së përmbarimit Komunës së Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1228/21, të datës 08.12.2022, i plotfuqishëm me datë 22.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 30.12.2022, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, në shumë të përgjithshme prej 996.00 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13 mars 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.URDHËROHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:191616 të datës 20.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1228/2021, të datës 08.12.2022, i plotfuqishëm me datë 22.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 30.12.2022, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, dhe atë - kreditorit Shpend Sylja nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 540.00 euro dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumë prej 456.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të përgjithshme prej 996.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitores së përmbarimit, Komuna e Gjakovës -

Drejtoria Komunale e Arsimit, t'i barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit, Ylli Bokshi avokat në Gjakovë në xhirollogarinë bankare, "Avokatura Bokshi" SH.P.K. me numër .... në Bankën TEB sh.a.

II. OBLIGOHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t'a njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarrimit, me aktvendimin 2021:191616, të datës 20.03.2023, ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 28.03.2023, ndërsa i autorizuari i kreditorit me datë 30.03.2023 ka paraqitur përgjigje në prapësim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorës, gjykata me aktvendim 2021:191616, të datës 02.11.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbarrim, ka cekur mjetin e përmbarrimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe se pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, t'ia paguaj kreditorit SH.S., nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 540.00 euro dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore në shumë prej 456.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të përgjithshme prej 996.00 euro, përmes bartjes së tyre në xhirollogarinë gjegjëse bankare dhe atë për këtë arsye:

Me shikim në shkresat e lëndës, 2021:191616, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarrimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1228/21, të datës 08.12.2022, i plotfuqishëm me datë 22.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 30.12.2022, për shkak të detyrimit në të holla, si në rastin konkret me debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare, sipas nenit 152 të LPP-së, duke u bazuar në dokumentin e lartë cekur të përmbarrimit, se debitorja, Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, është e obliguar që kreditores së përmbarrimit, ti paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë, vendosi që të urdhëroj

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në nenit 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

2021:191616, më 13 mars 2024

**GJ Y Q T A R,**

**Durim BALAJ**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.